

VENDIM
Nr. 45, datë 21.1.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 311, DATË 5.5.2010, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E AFATIT, TË PËRMBAJTJES DHE TË
MËNYRËS SË NJOFTIMIT PUBLIK PËR PROCEDURAT E KALIMIT TË SË DREJTËS
SË PRONËSISË MBI TRUALLIN SHETËTOR, NË ZONAT ME PËRPARËSI
TURIZMIN”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 10186, datë 5.11.2009, “Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shetëtor në zonat me përparësi turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 1, e vendimit nr. 311, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:
“1. Njoftimi për procedurat dhe dokumentacionin e nevojshëm për kalimin e së drejtës së pronësisë mbi truallin, në zonat me përparësi turizmin, publikohet:
a) në faqen zyrtare të ALUIZNI-t dhe të Agjencisë Kombëtare të Turizmit;
b) në dy gazeta kombëtare, për 5 ditë të njëpasnjëshme kalendarike;
c) pranë njësive përkatëse të qeverisjes vendore.”.
2. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale dhe Agjencia Kombëtare e Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama